

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5784
E enjte, 23 maj 2019
çmimi 0.40 €

Kërkohej drejtësi për masakrën në burgun e Dubravës



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

VËSHTRIM MBI SIGURINË NË KOMUNIKACION F. 11



Shkrim autorial nga
Ferat SHALA & Liridon SEJDIU

AKTUALE

POLICIA LANSON FUSHATËN 'TË GJITHË JEMI KËMBËSORË' F. 6

MUSTAFA DHE KURTI NISIN BASHKËPUNIMIN PËR RRËZIMIN E QEVERISË F. 5

EKONOMI

KËRKOHEJ TË RRIETET NUMRI I INSPEKTORËVE DHE KËSHILLUESVE BUJQËSORË F. 9

AUTOSTRADA 'ARBËN XHAFERI' NË FAZËN FINALE, PËRURIMI MË 29 MAJ F. 9



KULTURË

FILLOJNË APLIKIMET PËR PJESËMARRJE NË FESTIVALIN 'BUNARFEST' F. 6

SPORT

UEFA MBËSHTET FFK-në F. 14

ADMIRALI AMERIKAN JAMES FOGGO KA VIZITUAR REPUBLIKËN E KOSOVËS FAQE 3

Foggo: Tranzicioni i FSK-së duhet të ndodhë në bashkëpunim me NATO-n



Shefi i Komandës së Bashkuar i Aleancës në Napoli, admiral James Foggo, gjatë vizitës së tij në Kosovë dhe takimit me përfaqësues të qeverisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ka thënë se tranzicioni i FSK-së duhet të ndodhë në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n dhe bashkësinë ndërkombëtare. Gjatë vizitës në Ministrinë e Mbrojtjes, ku është pritur me nderime të larta ushtarake, admiral amerikan e ka përgëzuar FSK-në për të arriturat dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer me ekipin e NALT-it

Numri i lartë i agjencive të pavarura është bërë barrë për buxhetin e Kosovës

Në takim e radhës të Grupit të Veçantë për Reformën në Administratën Publike (GVRAP), ministri i Administratës Publike, Mahir Jaghillar, ka theksuar se numri i lartë i agjencive

të pavarura është barrë për buxhetin dhe frenon efektivitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Ai ka thënë se Ligji për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive

të pavarura, Ligji për zyrtarët publikë dhe Ligji për pagat në sektorin publik janë disa prej zhvillimeve kryesore të reformave gjithëpërfshirëse legjislativë për administratën publike FAQE 4



Kosova dhe Shqipëria, ofertë të përbashkët turistike FAQE 9



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rama i nis letër Bashës, e fton në dialog pa kushte

TIRANË, 22 MAJ - Kryeministri Edi Rama iu drejtua të mërkurën pasdite, përmes një letre të hapur, liderit demokrat Lulzim Basha, duke e ftuar atë për t'u ulur së bashku në një dialog pa kushte. Që në krye të letres së tij të shkurtër, të bërë publike përmes "Facebook"-ut, Rama thekson se "dialogu është e vetmja rrugë që demokracia njihet për trajtimin e mosmarrëveshjeve mes palëve". Më pas ai bën menjëherë të qartë se nuk mirëkupton zgjedhjet politike të

opozitës, vendimin e saj për t'i djegur mandatet apo dhe "bojkotin e paprecedent të zgjedhjeve dhe shantazhin mbi vendin e mbi qytetarët se opozita nuk do t'i lejojë ata të votojnë më 30 qershor", ka shkruar kryeministri.

Rama thekson se, pavarësisht kësaj, asgjë nuk e pengon që ta ftojë drejtuesin e opozitës për t'u ulur në tryezën e dialogut pa humbur kohë. Dialogun, tha Rama, s'mund ta pengojnë as pozicioni, sipas tij, ekstrem i

opozitës në lidhje me zgjedhjet vendore dhe as pamundësia e tij, po ashtu ekstreme, thekson ai në lidhje me datën kushtetuese të zgjedhjeve të cilat, vë në dukje kryeministri, opozita mund t'i vështirësojë, por nuk ka asnjë shans që t'i ndalojë të zhvillohen. Sipas Ramës, "jeta politike nuk mbaron më 30 qershor", prandaj ai e fton Bashën "në një dialog pa kushte, në kushtet kur Shqipëria e shqiptarët nuk meritojnë përkeqësimin e një situatë politike krejt të pakuptimtë, e



cila po u kushton në mënyrë krejt të pamerituar", ka shkruar Rama duke u shprehur,

megjithatë, se ka shumë pak shpresë se ftesa e tij do të merret parasysht.

Meta: Kufijtë nuk rivizatoohen aq kollaj

"Nuk ka komb në Ballkan që ka përfituar më shumë nga rënia e perdes së hekurt. Ne atë kohë ishim si Koreja e Veriut. Dëgjojmë pse mos të bashkohen të gjithë shqiptarët. Por pse të mos bashkohen të gjithë serbët, kroatët, boshnjakët dhe këto deliriume, gjoja patriotike, më shumë sesa folklorizëm, janë diabolizëm i gjallë. Është përpjekje e politikanëve autoritarë për t'u shmangur nga llogaria e brendshme për ta larguar vëmendjen e opinionit. Kufijtë nuk rivizatoohen aq kollaj", ka thënë Meta



TIRANË, 22 MAJ (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka folur me tone kritike ndaj tezave për bashkim të shqiptarëve në Ballkan në fjalën e tij në konferencën e organizuar nga Shoqata George C. Marshall Shqipëri, me temë "Sfidat e sigurisë në Ballkan dhe roli i aktorëve të jashtëm në kohën e tranzicionit euroatlantik". "Nuk ka komb në Ballkan që ka përfituar më shumë nga rënia e perdes së hekurt. Ne atë kohë ishim si Koreja e Veriut. Dëgjojmë pse mos të bashkohen të gjithë shqiptarët? Por pse të mos bashkohen të gjithë serbët, kroatët, boshnjakët dhe këto deliriume, gjoja patriotike, më shumë sesa, folklorizëm janë diabolizëm i gjallë. Është përpjekje e politikanëve autoritarë për t'u shmangur nga llogaria e brendshme për ta larguar vëmendjen e opinionit. E bëjnë

si në voleyboll, njëri pason dhe tjetri zhyt dhe çfarë ndodh? Ikin të rinjtë. Dëgjojmë që serbët dhe shqiptarët janë popujt kryesorë të rajonit. Është tjetër të thuash atë që bëri Franca me Gjermaninë që pas luftës nxorën mësim dhe është tjetër të thuash këtë të Ballkanit, pasi në Ballkan çdo popull është më i madhi, askush nuk pranon. Nuk rivizatoohen kufijtë aq kollaj", ka thënë Meta, duke shtuar se janë të vetëdijshëm se çfarë marrëdhënies të mira kishin Mali i Zi me Kosovën, por për një marrëveshje demarkacioni e dimë mirë se çfarë ndodhi. "Dua të bëj të qartë, ne i kemi të gjitha mundësitë sikur e kemi treguar që të jemi faktorë stabilizues", ka shtuar presidenti Meta.

Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, e cila mori pjesë në këtë konferencë, ka bërë me dije se në veçanti u diskutua për

sfidat e sigurisë në kuadër të përpjekjeve dhe rrugës sonë drejt integritit euroatlantik. Ajo ka theksuar nevojën për

mbështetje të vazhdueshme të aleatëve tanë euroatlantikë, të BE-së dhe ShBA-së, me qëllim të arritjes së paqes së qën-

drueshme në rajon dhe implementimit të reformave që na sjellin më afër partnerëve tanë euroatlantikë.

Zaevi: Liderët do të njoftohen për shkarkimet

SHKUP, 22 MAJ - Kryeministri i Maqedonisë Veriore, Zoran Zaev, nuk do të ndërmarë asnjë hap për ndryshime në qeveri pa i njoftuar partnerët e koalicionit. Duke mos komentuar emrat e përfolur deri më tani, i pari i organit ekzekutiv thekson se liderët do të njoftohen në detaje për lëshimet që kanë bërë funksionarët të cilët i kanë caktuar. "Është e rrugës që si

mandatar t'i njoftoj partnerët e koalicionit me lëshimet e konstatuara nga personat dhe funksionarët e caktuar të cilët dua të largohen. Sapo t'i marr vendimet, do t'i kumtoj para publikut. Është e rrugës që ai i cili e ka nominuar ose caktuar një funksionar të njoftohet se do t'i largohet i nominuari", tha Zaevi. I pyetur për qëndrimet e funk-

sionarëve të BDI-së, të cilët tashmë disa herë kanë deklaruar se vetëm kryetari i tyre mund të vendosë për fatin e tyre, Zaevi ka shtuar se gjithçka do të merret vesh pasi propozimet të dërgohen në Kuvend. "Mishmashi i deklaratave të funksionarëve të lartë të BDI-së që po e dëgjojmë këto ditë do të merret vesh në fund kur do të kuptohet e vërteta

për të cilën po flasim. Unë jam propozuesi, ndërsa ata mund të votojnë ose jo në Kuvend. Kur do t'i dërgoj propozimet në Kuvend, Artan Grubi është deputet dhe ai bashkë me grupin e tij parlamentar do të shprehen për vendimet. Për këtë arsye kisha takim me liderin e tyre, që në kohë ta dinë se cilat vendime do t'i marr dhe të diskutojnë në parti", tha Zaevi.



Admirali amerikan James Foggo ka vizituar Republikën e Kosovës

Foggo: Tranzicioni i FSK-së duhet të ndodhë në bashkëpunim me NATO-n

Shefi i Komandës së Bashkuar i Aleancës në Napoli, admirali James Foggo, gjatë vizitës së tij në Kosovë dhe takimit me përfaqësues të qeverisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ka thënë se tranzicioni i FSK-së duhet të ndodhë në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n dhe bashkësinë ndërkombëtare. Gjatë vizitës në Ministrinë e Mbrojtjes, ku është pritur me nderime të larta ushtarake, admirali amerikan e ka përgëzuar FSK-në për të arriturat dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer me ekipin e NALT-it

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 MAJ - Shefi i Komandës së Bashkuar të Aleancës në Napoli, admirali James Foggo, ka takuar të mërkurën ministrin e Mbrojtjes, Rustem Berisha dhe komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrahman Rama, me të cilët ka diskutuar për gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe tranzicionin e FSK-së. Përmes një komunikate për media KFOR-i ka bërë me dije se në këtë takim është diskutuar për gjendjen e sigurisë në Kosovë, në kontekstin e misionit të KFOR-it, për të siguruar një mjedis të qetë për të gjithë njerëzit në Kosovë.

Foggo është cituar të ketë thënë se pret që tranzicioni i FSK-së të

jetë në koordinim me NATO-n. "Foggo përsëriti pritshmërinë e tij që tranzicioni i FSK-së të jetë një përpjekje progresive, transparente dhe gjithëpërfshirëse si dhe e koordinuar ngushtë me NATO-n dhe bashkësinë ndërkombëtare", është thënë në komunikatën e KFOR-it. Po ashtu, ai ka deklaruar se NATO-ja mbetet e angazhuar përmes KFOR-it për një mjedis të qetë dhe të sigurt në Kosovë dhe stabilitet në rajonin e gjerë të Ballkanit Perëndimor.

Ndërsa Ministria e Mbrojtjes ka treguar se takimi ndërmjet Ministrit të Mbrojtjes, Rustem Berisha dhe admiralit amerikan Foggo ishte fokusuar në situatën e sigurisë në Kosovë e rajon, tranzicionin e FSK-së, bashkëpunimin me partnerët strategjikë si dhe qëllimin e palëkundur të Kosovës

për anëtarësim në NATO dhe fokusimin në ndërtimin e kapaciteteve që garantojnë paqen në vend, rajon e më gjerë.

Ministri Berisha e ka njoftuar admiralin Foggo rreth procesit transparent të tranzicionit të FSK-së dhe koordinimin e vazhdueshëm me partnerët strategjikë. "Në bashkëpunim me partnerët kemi përgatitur Planin Gjithëpërfshirës Transitor. Zbatimi i këtij plani është gradual, gjatë dhjetë vjetëve të ardhshëm dhe ndahet në tri faza. Ministria e Mbrojtjes është e përkushtuar që tranzicioni të bëhet në mënyrën e duhur dhe ky proces merr kohë.

Janë përmbushur detyrat e fazës së parë A 120 + ditësh të Planit Gjithëpërfshirës Transitor sa i përket infrastrukturës ligjore dhe administrative", ka thënë Berisha. Ai ka çmuar lart bashkëpunimin me misionin e KFOR-it në Kosovë, i cili, sipas tij, ka dhënë kontribut të pazëvendësueshëm për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon, si ekipin e NALT-it për bashkëpunimin dhe këshillimin e vazhdueshëm në çdo hap të ecjes tone përpara.

Ministri Berisha ka përsëritur zotimin se FSK-ja edhe me mandatin e ri do të jetë forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme, ku diversiteti është dhe do të mbetet vlerë, ku barazia është për të gjithë. "Qytetarët e Kosovës janë të gjithë të barabartë, pa marrë parasysh përkatësinë. FSK-ja për vite me radhë është institucioni që gëzon besimin më të lartë në Kosovë nga qytetarët", ka deklaruar Berisha. Në fund të takimit me admiralin amerikan, Berisha ka theksuar se Republika e Kosovës është përkushtuar për paqe, siguri, stabilitet dhe bashkëpunim me të gjithë. "Kemi bashkëpunim të shkëlqyer me të gjitha vendet e rajonit që janë anëtare të NATO-s dhe ato që aspirojnë anëtarësim në NATO. Ne jemi të bindur se paqja e përhershme arrihet me anëtarësimin e secilit shtet të rajonit në NATO", është shprehur

ai. Nga ana e tij, sipas komunikatës për medie të Ministrisë së Mbrojtjes, komandanti i Komandës së Bashkuar të Aleancës në Napoli, admirali James Foggo, ka përgëzuar ministrin dhe komandantin për të arriturat e FSK-së dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me ekipin e NALT-it.

Admirali e ka konsideruar sukses të jashtëzakonshëm të Kosovës pjesëmarrjen e FSK-së me dy kadetë në Akademinë Ushtarake Amerikane West Point si dhe angazhimet e tjera në të mirë të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të institucionit dhe shoqërisë. Ndërsa në takimin me komandantin e FSK-së, gjeneral Rama me admiralin amerikan Foggo, është vlerësuar lart kontributi i NATO-s përmes KFOR-it dhe NALT-it në mbështetje të këshillimit dhe zhvillimit profesional të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Aktualisht admirali Foggo udhëheq Komandën e Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli e cila mbikëqyr KFOR-in. Tranzicioni i FSK-së në ushtri është finalizuar në fund të vitit 2018, pas mbështetjes që Kosovës i erdhi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aktualisht FSK-ja numëron 2 500 pjesëtarë të rregullt dhe 800 rezervistë, kurse me mandatin e ri parashihet të ketë 5000 ushtarë aktivë dhe 3 000 pjesëtarë rezervë.



Deputetët diskutojnë me qytetarë të Lipjanit

Lipjan, 22 maj (ER) - Ka vazhduar të mërkurën në Lipjan ciklin e debatëve të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës me qytetarë të qendrave të ndryshme komunale. Aktiviteti "Ditët e Kuvendit", i iniciuar nga Forumi për Transparencë Parlamentare dhe i mbështetur nga NDI, ka përqendrim t'ua japë shansin qytetarëve të

komunave të ndryshme të kenë komunikim me përfaqësuesit e tyre për t'i shprehur shqetësimet dhe kërkesat.

Deputetët Naser Osmani (LDK), Glauk Konjufca (LV), Ahmet Isufi (AAK), Sali Salihu (PSD) dhe Haxhi Shala (Nisma) u janë përgjigjur qytetarëve në adresimet e tyre lidhur me çështjet që ata i

shqetësojnë, nga problematikat lokale, deri te zhvillimet e rëndësishme shtetërore.

Ndryshimi i ligjit zgjedhor ishte një prej çështjeve që u diskutua në këtë takim.

Qytetarët kërkuar krijimin e më shumë zonave zgjedhore, në mënyrë që secili deputet ta ketë bazën e caktuar elektorale.



Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian diskutojnë për reformën e administratës publike

Numri i lartë i agjencive të pavarura është bërë barrë për buxhetin e Kosovës

Në takimin e radhës të Grupit të Veçantë për Reformën në Administratën Publike (GVRAP), ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka theksuar se numri i lartë i agjencive të pavarura është një barrë për buxhetin dhe frenon efektivitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Ai ka thënë se Ligji për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, Ligji për zyrtarët publikë dhe Ligji për pagat në sektorin publik janë disa prej zhvillimeve kryesore të reformave gjithëpërfshirëse legislative për administratën publike. Përfaqësuesi i Komisionit Evropian, David Cullen, ka thënë se ky komision mbetet i shqetësuar në aspektin e vendimeve të qeverisë lidhur me emërimet e larta në shërbimin civil

ligjet. Ministri Jagxhillar vuri në dukje se tri ligjet do të sjellin ndryshime të mëdha në administratën publike, duke përfshirë procedurat për rekrutimin dhe vlerësimin e performancës së nëpunësve civilë. Ai, po ashtu, ka vlerësuar rëndësinë e procesit të racionalizimit të agjencive të pavarura. Ministri Jagxhillar ka deklaruar se numri i lartë i agjencive të pavarura është një barrë për buxhetin dhe frenon efektivitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Ai ka përsëritur angazhimin e qeverisë dhe përkrahjen e Kuvendit për ta përfunduar me sukses procesin e racionalizimit, duke vënë në dukje se tashmë është miratuar plani i veprimtimit për racionalizim dhe Ministria e Administratës Publike është duke kryer konsultime të gjera për opsionet e racionalizimit. Ndërsa David Cullen, shef i Njësisë për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negocimet e Zgjerimit në Komision Evropian, duke vlerësuar pozitivisht angazhimin e ministrit Jagxhillar dhe ministrisë në procesin e aprovimit të pakos legislative të reformës së administratës publike, ka theksuar se të tri këto ligje janë esenciale për Kosovën dhe se përparimi në këtë drejtim nuk mund të mohohet. Cullen ka ofruar përkrahjen e Komisionit Evropian rreth procesit të racionalizimit të agjencive. Ai ka pohuar se Komisioni Evropian mbetet i shqetësuar në

aspektin e vendimeve të Qeverisë lidhur me emërimet e larta në shërbimin civil si dhe ka ritheksuar rëndësinë e stabilitetit makro-fiskal. Kurse ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, tha se ministria që drejton, si një ndër ministritë kryesore që përkujdeset për përmirësimin e klimës së të bërit biznes në Kosovë, është duke mbajtur një rol aktiv në disa procese të rëndësishme reformuese që ndërlidhen ngushtë me procesin e reformës shtetërore si dhe zvogëlimin e barrës administrative dhe thjeshtëzimin e lejeve dhe licencave në Kosovë. "Sa iu përket shërbimeve, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me projektin e BE-së, ka përfunduar rishikimin e legjislacionit vendor ku është analizuar se a është në harmoni me Direktivën e BE-së 2006/123/KE. Direktiva e Shërbimeve synon ta lehtësojë themelimin dhe ofrimin e shërbimeve në vendet e tjera anëtare dhe të ofrojë shërbime ndërkuftare mes vendeve anëtare të BE-së. Gjatë rishikimit të legjislacionit 54 ligje dhe akte nënligjore janë identifikuar që duhet të plotësohen/ndryshohen", ka thënë Shala gjatë raportimit në Grupin e Veçantë të Administratës Publike. Ministri Shala ka theksuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka vendosur në fokus të posaçëm edhe aktivitete të tjera që ndërlidhen me procesin e reduktimit të barrës administrative. "Mund t'ju konfirmoj se

MTI-ja është një ndër institucionet e para në Kosovë që është duke zbatuar procesin e thjeshtëzimit të lejeve dhe licencave që lëshohen nga agjencitë dhe departamentet përkatëse të MTI-së. Këtë aktivitet jemi duke e bërë në bashkëpunim të ngushtë me projektin 'Klima e Investimeve II' të implementuar nga IFC/Banka Botërore dhe MTI ka identifikuar reformat e nevojshme", ka thënë Shala. Në mbledhjen e Grupit të Veçantë për Reformën e Administratës Publike ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (BE) ka marrë pjesë edhe zëvendësministri i Integritimit Evropian, Lirak Çelaj, me ç'rast ka deklaruar se përkushtimi ndaj reformës së administratës publike është ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës. "Pa reformë të mirëfilltë të administratës publike është e pamundur të arrihen standarde dhe praktika më të mira të BE-së në këtë drejtim. Prandaj, përkushtimi institucional për krijimin e një administrate publike eficiente dhe efektive për institucionet e Kosovës duhet të jetë e para ndër të parat", ka theksuar Çelaj. Ai ka thënë se zbatimi sa më i mirë i politikave dhe legjislacionit që prek reformën e administratës publike dhe menaxhimin e financave publike do të kontribuojë në arritjen e caqeve të parapara në procesin integruar. Çelaj ka inkurajuar institucionet të mos shkaktojnë vonesa sepse, sipas tij, çdo vonesë mund t'i kushtojë Kosovës në rrugëtimin drejt BE-së.

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 MAJ - Nën kryesimin e ministrit të Administratës Publike, Mahir Jagxhillar dhe David Cullen, shef i Njësisë për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negocimet e Zgjerimit në Komision Evropian, është mbajtur takimi i radhës i Grupit të Veçantë për Reformën në Administratën Publike (GVRAP). GVRAP-ja është pjesë e strukturave të koordinimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe shërben si strukturë dialogu midis qeverisë dhe BE-së dhe monitoron zbatimin e kërkesave të integritimit në BE lidhur me reformat e administratës publike. GVRAP zakonisht mbledhet dy

herë në vit dhe nxjerr konkluzione dhe rekomandime. Në hapje të takimit ministri Jagxhillar ka falënderuar Komisionin Evropian për mbështetjen e vazhdueshme në zbatimin e reformave të administratës publike. Ai ka theksuar se disa prej zhvillimeve kryesore në vitin 2018 ishin: përfundimi i procesit të zhvillimit të reformave gjithëpërfshirëse legislative për administratën publike, përkatësisht Ligji për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, Ligji për zyrtarët publikë dhe Ligji për pagat në sektorin publik, që u miratuan në fillim të këtij viti nga Kuvendi i Kosovës. Jagxhillar ka thënë se me ndihmën e Komisionit Evropian ka filluar puna për ta zhvilluar legjislacionin sekondar për tri





Takohen liderët e dy subjekteve më të mëdha opozitare

Mustafa dhe Kurti nisin bashkëpunimin për rrëzimin e qeverisë

Liderët e dy subjekteve më të mëdha opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV), i kanë lënë mbrapa mospajtimet e dikurshme për të formuar një bllok opozitar kundër qeverisë së koalicionit PAN. Mustafa dhe Kurti janë takuar të mërkurën për t'u pajtuar që t'i fillojnë përgatitjet e nevojshme për rrëzimin e qeverisë

erisë", ka shkruar Kurti. Më pas Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) përmes një komunikate për media ka dhënë detaje për takimin. Sipas LDK-së, të dy liderët e partive opozitare në Kosovë diskutuan për organizimin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë së koalicionit PAN. "LDK-ja në nëntor të vitit të kaluar kishte aprovuar platformën zgjedhore duke konstatuar se institucionet e dala nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017 nuk po e bëjnë punën e tyre në interes të vendit dhe të forcimit e të konsolidimit të shtetit të Kosovës, se Kuvendi i Republikës së Kosovës është bërë jofunksional dhe se Qeveria e koalicionit qeverisës nuk përfaqëson shumicën në Kuvend. Rrjedhimisht, LDK-ja vlerësoi se vendi duhet të shkojë në zgjedhje përmes votës së mosbesimit ndaj Qeverisë aktuale ose përmes shpërndarjes së Kuvendit duke

kërkuar nga të gjitha organet e LDK-së angazhim të plotë dhe të gjithanshëm për zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme", është bërë me dije në këtë komunikatë, duke shtuar se situata në Kosovë po keqësohet. "Z Mustafa dhe z. Kurti vlerësuan se, edhe përkundër faktit që grupet parlamentare të LDK-së dhe të LV-së bashkërenditën aktivitetin opozitar kundër qeverisjes së dëmshme dhe një mori skandaleve të kësaj qeverie dhe të këtij koalicioni, situata në Kosovë po përkeqësohet. Korrupsioni i lartë, papunësia, nepotizmi dhe ikja e njerëzve nga Kosova janë dëshmitë më të mira se vendit i nevojitet qeveri e re e përgjegjshme. Në ditët në vijim, grupet parlamentare do të veprojnë në organizimin e mocionit", është thënë në komunikatën e LDK-së. Dite më parë kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka paralajmëruar

se bashkë me dy subjektet e tjera opozitare do ta nisin mbledhjen e nënshkrimeve për mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë. Ai pati bërë me dije se për këtë qëllim do ta takojë edhe kryetarin e PDS-së, Shpend Ahmetin. Ky i fundit e ka mirëpritur një iniciativë të tillë dhe ka shprehur gatishmërinë për një takim të tillë. "Mirëpres paralajmërimet dhe iniciativat për konsultime opozitare për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. PSD-ja ka qenë dhe është e gatshme t'i koordinojë veprimet në interes të shtetit të Kosovës", pati deklaruar Ahmeti.

Tri partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Socialdemokrate, i kanë gjithsej 56 deputetë në Kuvendin e Kosovës dhe për suksesin e një mocioni të mosbesimit për qeverinë, nevojiten edhe pesë vota të deputetëve.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 22 MAJ - Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, dhe ai i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, janë takuar të mërkurën për të diskutuar rreth mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë. I pari që e ka konfirmuar takimin ka qenë kryetari i LV-së, Albin Kurti, i cili në profilin e vet në "Facebook" ka treguar se me të parin e LDK-së janë pajtuar që t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme për rrëzimin e qev-

gatitjet e nevojshme për rrëzimin e qeverisë. "Sot takova kryetarin e LDK-së, z. Isa Mustafa. Biseduam për situatën politike dhe iniciativën për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Kosova ka nevojë për zhvillim ekonomik e jo për korrupsion institucional. Qytetarët duan qeverisje të re, të mirë e të drejtë dhe jo keq-qeverisje që na e rrit borxhin, zhatat buxhetin dhe falimenton ndërmarrjet. U pajtuam që t'i bëjmë përgatitjet e nevojshme për rrëzimin e qev-

O'Connelli për masakrën e Vushtrrisë: Çdo viktimë në Kosovë meriton drejtësi

PRISHTINË, 22 MAJ (ER) - Ambasadori britanik në Kosovë, Ruari O'Connell, së bashku me kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, kanë bërë homazhe të mërkurën te varrezat e martirëve me rastin e 20-vjetorit të masakrës në Vushtri.

Ambasadori britanik përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar se pas homazheve ka takuar në Vushtri familjet e viktimave të masakrës së 22 majit të vitit

1999. Ai ka thënë se çdo viktimë, pa dallim nëse janë shqiptarë, serbë, romë, ashkali, boshnjakë, meritojnë drejtësi. "Më shumë se çdo gjë, ata meritojnë që përjetimet e tyre të tregohen dhe të pranohen", ka thënë O'Connell. Ai ka theksuar se pajtimi fillon duke treguar dhe dëgjuar të vërtetën. "Ne duhet të kujtojmë dhe pranojmë atë se çka ka ndodhur në Kosovë. Unë isha i prekur me atë se çka më tha sot një grua që kishte humbur vëllanë: 'Ne nuk duam hakmarrje.



Ne dëshirojmë drejtësi, që kjo mos të ndodhë më kurrë", ka thënë O'Connell.

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka falënderuar ambasadorin e Ruairi O'Connell për vizitën në Vushtri, siç ka thënë ai, "në këtë datë të dhimbjes së madhe për familjarët dhe për qytetin".

Ndërkaq kryeministri Ramush

Haradinaj ka thënë se në 20-vjetorin e masakrës në Vushtri, ku u ekzekutuan brenda pak orësh dhjetëra shqiptarë dhe shumë të tjerë u plagosën, Kosova e vazhdon betejën e saj për të vërtetën. "Këtë ditë, Vushtria dhe mbarë Kosova e kanë kthyer në kujtesë institucionale, si dëshmi ndër breza se sa e vështirë ishte rruga jonë deri në liri. Shteti serb, me

gjithë gjenocidin mbi shqiptarët, edhe pas dy dekadave refuzon ta pranojë të vërtetën dhe të përgjigjet për krimet e kryera. Nuk do të lejojmë që masakrat më makabre në tërë Kosovën të kalojnë pa u dënuar. Kosova nuk harron", ka thënë Haradinaj. Më 22 maj të vitit 1999 në këtë qytet konsiderohet të jenë vrarë 77 shqiptarë nga forcat serbe.

Radiologjia do të transformohet në klinikë moderne

Me angazhimin e menaxhmentit dhe përkushtimin e personelit në Klinikën e Radiologjisë është hequr lista e pritjes për pacientë të hospitalizuar për shërbimet e Tomografisë së Kompjuterizuar (CT) dhe është zvogëluar lista e pritjes për pacientët ambulatorë për kontrollimet me rezonancë magnetike pas angazhimit të stafit gjatë natës dhe fundjavave

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 MAJ - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës po investon në radiologji përmes projektit të transformimit në një klinikë moderne. Investimet kapitale kanë filluar dhe së shpejti do të instalohet rezonanca e dytë magnetike, blerë së fundmi, si dhe Tomografia e Kompjuterizuar (CT). Me angazhimin e menaxhmentit dhe përkushtimit të personelit në Klinikën e Radiologjisë

është hequr lista e pritjes për pacientë të hospitalizuar për shërbimet e Tomografisë së Kompjuterizuar (CT) dhe është zvogëluar lista e pritjes për pacientët ambulatorë për kontrollimet me rezonancë magnetike pas angazhimit të stafit gjatë natës dhe fundjavave. Deri tash pacientët kanë pritur deri në një vit për rezonancë, kurse tani lista e pritjes është reduktuar në vetëm dy muaj. Vlen të theksohet, gjithashtu, se është eliminuar rrjedhja e rrezatimit në disa kabine, që është konfir-



muar me raportin e Agjencisë për Mbrojtjen nga Rrezatimi. Planifikimi i renovimit të tërësishëm për instalimin e sistemit të ri të ventilimit, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira në punë, që ka munguar për disa vjet, është në përfundim. Teknikëve të radiologjisë në kujdestari u është zvogëluar orari i punës, kurse me propozimin e vetë radiologëve të gjithë do të jenë të inkuadruar në orar të kujdestarisë.

Klinika e Radiologjisë ka punuar edhe në ngritjen profesionale të stafit sipas teknikave të fundit imazherike. Me rritjen e numrit të kompjuterëve dhe instalimin e printerëve, për herë të parë në çdo hapësirë, radiologët kanë kushte më të mira të punës. Me angazhimin profesional të teknikëve, përdorimi i blendave dhe i mbrojtjes jep siguri nga rrezatimi për pacientët e shërbyer.

Policia lanson fushatën 'Të gjithë jemi këmbësorë'

Prishtinë, 22 maj (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Divizioni i Komunikacionit Rrugor, përkrahur nga Departamenti Koordinues i Këshillit për Siguri Rrugore - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka lansuar fushatën vetëdijesuese "Të gjithë jemi këmbësorë". Në kuadër të këtij aktiviteti në të cilin

morën pjesë zyrtarë të lartë nga Policia e Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit është bërë edhe shpërndarja e fletushkave që kanë për qëllim sensibilizimin e pjesëmarrësve në trafik, sidomos këmbësorëve, të cilët janë kategoria më e rrezikuar në trafikun rrugor. Përdorimi i rrugës duhet të përdoret në

mënyrë sociale, që nënkupton se këmbësorët duhet t'i respektojnë vendkalimet për këmbësorë dhe vendet e tjera të lejuara. Gjithashtu, edhe shoferët duhet të lëvizin konform rregullave të trafikut, pa i penguar pjesëmarrësit e tjerë. Çdo shkelje e rregullave të trafikut mund të kuptohet edhe si humbje e jetës.



Është përkujtuar 20-vjetori i masakrës në burgun e Dubravës

Kërkohet drejtësi për masakrën në burgun e Dubravës

Themelimi i tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë është i pashmangshëm dhe nuk ka asnjë forcë që mund ta ndalë. Kështu ka deklaruar kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në shënimin e 20-vjetorit të masakrës në burgun e Dubravës. Ai ka thënë se vrasja masive e shqiptarëve në këtë burg është një prej dëshmive më të qarta të gjenocidit të shtetit serb në Kosovë. Ndërkohë të mbijetuarit e masakrës në burgun e Dubravës kanë kërkuar nga institucionet që ta ndriçojnë të vërtetën e kësaj masakre

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 MAJ - Në nderim të viktimitave të masakrës në burgun e Dubravës të mërkurën është mbajtur një ceremoni shtetërore me rastin e shënimit të 20-vjetorit të kësaj masakre. Të pranishëm në këtë përvjetor, përveç familjarëve të viktimitave dhe të mbijetuarve, ka qenë edhe kryeparlamentari Kadri Veseli, deputetë dhe politikanë të tjerë. Edhe pse kryeministri Ramush Haradinaj kishte paralajmëruar pjesëmarrjen, në momentin e fundit e ka anuluar. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se tribunali ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë është i pashmangshëm dhe nuk do të ketë forcë që mund ta ndalë. "Kosova duhet të përgatitet, duke e vënë drejtësinë në vend për gjenocidin serb, edhe për jetën në fqinjësi të mirë, edhe në paqe me të gjithë, edhe me Serbinë. Ndaj këtij gjaku të derdhur në këtë vend dhe ndaj gjithë atyre që kanë rënë për lirinë e kësaj toke, e kemi borxh ne të gjallët t'i përkujtojmë, por të punojmë edhe më shumë që e kaluara më të mos përsëritet kurrë dhe të punojmë që çdo ditë të kemi një të ardhme të sigurt për fëmijët tanë derisa tribunali ndërkombëtar për

gjenocidin serb në Kosovë do të ndodhë. Ai është i pashmangshëm dhe nuk ka asnjë forcë që mund ta ndalë", ka theksuar Veseli, duke ftuar subjektet politike që të jenë të bashkuara në këtë iniciativë. Ai ka deklaruar se vrasja masive e shqiptarëve në burgun e Dubravës është një prej dëshmive më të qarta të gjenocidit të shtetit serb në Kosovë.

Veseli ka thënë se ky krim mizor i përgatitur dhe i realizuar në gjakftohtësi të plotë shpërfaq një prej dimensioneve më çnjerëzore të shtetit serb, ndërsa dëshmitë e të mbijetuarve lirisht mund të përshkruhen si dëshmi të ferrit mbi tokë. "Grumbullimi i tërë të dënuarve shqiptarë në një vend, madje duke i tubuar të gjithë ata në Kosovë, ku ndërmarra e autoriteteve politike, policore dhe ushtarake serbe për zhdukjen e shqiptarëve ishte në veprim të gjerë, është pasqyrim i saktë i këtij gjenocidi", ka deklaruar Veseli, duke shtuar se Serbia edhe sot nuk ka as mëdyshjen minimale për t'u zbrapsur nga e kaluara e vet kriminale. Ai ka thënë se Serbisë kjo i bëhet edhe më e lehtë përderisa nuk përballlemi me atë, por në mes vete. Veseli ka theksuar se Kosova ka nevojë për perspektivë të qartë dhe të ardhme të sigurt mirëpo, sipas tij, është e vështirë të mendohet për të ardhmen duke vuaj-

tur pasojat e së kaluarës. "Nuk mund të vazhdojmë çdo vit njësoj, me të njëjtat fjalë dhe me të njëjtën pafuqi. Nuk guxojmë ta rrezikojmë të ardhmen e fëmijëve tanë, duke mbjell frymën e dorëzimit. Kështu na rrezikohet vetëm të përsëritet historia. Shteti i Kosovës duhet të veprojë konkretisht për të kërkuar drejtësi për gjenocidin serb në Kosovë. Vendimi institucional për ta adresuar dhimbjen e kombit tonë, me kërkesa të qarta për vetveten, Serbinë dhe bashkësinë ndërkombëtare, është i domosdoshëm. Jam i sigurt në përkrahjen e botës perëndimore për këtë", ka thënë Veseli.

Të mbijetuarit e masakrës së Dubravës kanë kërkuar nga drejtësia vendore e ndërkombëtare t'i gjykojë kriminelët serbë. I mbijetuari i kësaj masakre, Bajrush Xhemajli, ka theksuar se gjatë historisë sonë në luftë për çlirim, okupatorët e shumë kanë bërë masakra të njëpasnjëshme, por kjo e Dubravës pa dyshim mbanë një rekord të zi. "Për pesë ditë me radhë të burgosurit kanë parë

duke vlarë mbi 120 shokë të tyre, duke plagosur mbi 300 nga ta dhe duke pritur secili se kur do të vritet edhe vetë, ashtu që, në këtë llahtar, dy prej të burgosurve në pamundësi të qëndrojnë para këtij tmerrri, kanë gjetur shpëtimin duke u varur në litar. Pesë ditë ferr, i pashpresë", ka thënë Xhemajli. Ai ka treguar se për gjithë këtë vepër makabër ish të mbijetuarit e kësaj masakre në emër të Shoqatës së të Burgosurve Politikë kanë ngritur padi më 19 janar 2007 në Gjykatën e Pejës por, sipas tij, gjithë kjo u hesht.

Xhemajli ka theksuar se përderisa dihen veprimet kriminale dhe dihen aktorët për të cilët ka fakte të mjaftueshme, heshtja e institucioneve tona nuk ka se si arsye dhe është e pakuptueshme. "Faktet janë të pamohueshme dhe janë dërguar atje ku duhen ngritur çështjet. Zëri i institucioneve nuk është dëgjuar. Kjo heshtje varri nga institucionet tona ka shtruar shumë dilema. Pse kjo heshtje përballë të gjitha fakteve që kemi. Kujt i ka interesuar kjo heshtje. Me dashje e pa

dashje është përligjur krimi. Gjithsesi nga heshtja jonë ka përfituar Serbia për fshehjen e krimi. Kjo tregon papërgjegjshmërinë e institucioneve tona deri dje", ka thënë ai.

Xhemajli ka folur edhe për iniciativën e themelimit të tribunalit për krimet serbe, duke theksuar se kjo iniciativë si dhe mbajtja e një seance për masakrën e Dubravës ka thyer heshtjen e politikës. "Iniciativa për ngritjen e tribunalit për krimet serbe, seanca e djeshme, bashkë me praninë e juaj sot këtu, theu heshtjen politike rreth masakrës, që na jep shpresë se, më në fund, kjo punë po merr udhë në vendosjen e drejtësisë. Kjo do të ishte një si balsam në zemrat e të gjithë familjarëve të të rënëve, e të gjithë atyre të të plagosurve në këtë burg dhe neve të cilët mbijetuarim këtë masakër", ka deklaruar ai. Sipas Xhemajlit, masakra në burgun e Dubravës rëndon në ndërgjegjen e vlarë kombëtare dhe ndërkombëtare. "Duhet që institucionet tona ta ndriçojnë të vërtetën, gjithsesi", ka theksuar ai.



Kërkohet të rritet numri i inspektorëve dhe këshilluesve bujqësorë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

KAMENICË, 22 MAJ - Shtimi i numrit të inspektorëve dhe këshilluesve bujqësorë po shihet të jetë nevojë e domosdoshme me qëllim që në Kosovë të ketë siguri më të madhe ushqimore. Ndërkaq rritja e cilësisë së produkteve dhe prodhimeve 'bio' po konsiderohet hap i rëndësishëm që prodhimet vendore të depërtojnë në tregun e Bashkimit Evropian.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se kjo komunë ka përparësi shumë të madhe për zhvillim të bujqësisë pasi që 70 për qind e territorit të saj janë hapësira kodrinore-malore. Kastrati ka thënë se është ngritur vetëdija e qytetarëve për të investuar në këtë veprimtari, pasi që këtë vit janë rreth dyzet përfitues të granteve të Ministrisë së Bujqësisë, kurse në vitet e mëparshme kanë qenë jo më shumë se tetë. "Në vitet e fundit buxheti për subvencione për të gjitha kategoritë ka qenë 9 925 euro, që nënkupton subvencione jo vetëm në bujqësi, por në të gjitha fushat. Ne jemi duke



kërkuar nga niveli qendror që të ndajë fonde shtesë. Vitin e kaluar edhe këtë vit kemi arritur për të marrë një fond jo të mjaftueshëm. Ne si shtet duhet ta zvogëlojmë burokracinë në aspektin e shpërndarjes së

subvencioneve dhe granteve", ka thënë Kastrati.

Nga Departamenti për Këshilla Bujqësore që vepron në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përfaqësuesi Tahir Halitaj ka

theksuar se ministria ka hartuar mekanizma shtesë për t'i zbatuar në tërësi standardet e Bashkimit Evropian. Megjithatë, sipas tij, politikat për përfitues të granteve duhet t'u përshtaten edhe prodhuesve të vegjël.

"Edhe ne e vlerësojmë që kemi nevojë për këshilltarë që i zbatojnë standardet. Numri i këshilltarëve është i kufizuar për shkak të buxhetit të qeverisë dhe nuk mund të pranohen punëtorë, por ne e kemi mekanizmin e certifikimit të këshilltarëve privatë dhe të licencimit të kompanive që na plotësojnë në terren me këshilla", ka thënë Halitaj.

Sabedin Kadriu, koordinator rajonal për Gjilan në AUVK, ka pohuar se me kapacitetet e vogla të inspektorëve që kanë në dispozicion po mundohen të ofrojnë siguri ushqimore për qytetarët e këtij regjioni. "Sa i përket sigurisë ushqimore, thashë në fillim, jemi duke e bërë të pamundurën të mundur, mirëpo me atë kapacitet që e kemi të fuqisë punëtore, konkretisht të inspektorëve, është shumë i vogël", është shprehur ai.

Ky debat për fushëveprimtarinë bujqësore në Kosovë u zhvillua në kuadër të projektit "Përkrahje për Komunikim në Procesin e Integritimit Evropian" që financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian.



Ministri Matoshi: E ardhmja jonë do të varet shumë nga trajtimi i mbeturinave

PRISHTINË, 22 MAJ (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka pritur në takim një grup të studentëve dhe profesorëve të Universitetit të Berlinit, me të cilët ka diskutuar për fillimin e projektit mbi analizimin e situatës së mbeturinave nga ndërtim demolimi në Kosovë. Gjatë këtij takimi Matoshi ka

falënderuar studentët dhe profesorët për praninë e tyre dhe studimin që ata po bëjnë tani në Kosovë mbi mbeturinat e ndërtim demolimit si dhe ka prezantuar sfidat me të cilat po ballafaqohet shteti i Kosovës në fushën e mjedisit. "E ardhmja jonë do të varet shumë nga drejtimi që do t'u japim këtyre problemeve mjedisore dhe

raporti që ju do të bëni do të na ndihmojë në punën tonë", ka deklaruar ministri Matoshi, duke shtuar se Kosova ka qenë e okupuar dhe sunduesit e saj nuk janë brengosur për mjedisin dhe planifikimin hapësinor të Kosovës prandaj, sipas tij, janë këto probleme të cilat po trajtohen seriozisht. Ministri Matoshi para studen-

tëve ka folur edhe për investimet që po bëhen në fushën e mbeturinave, duke thënë se bashkë me GIZ-in janë duke investuar 7 milionë euro për mbështetjen e komunave në këtë fushë.

Ndërkaq udhëheqësja e programit të mbeturinave në GIZ, Alexandra Linden, ka falënderuar ministrin Matoshi

për bashkëpunimin dhe ka treguar për projektet e përbashkëta që po zhvillohen në fushën e mjedisit nga MMPH-ja dhe GIZ-i.

Në fund të takimit Matoshi ua ka dhuruar të pranishmëve nga një hartë të Kosovës në shenjë falënderimi për vizitën dhe punën që po bëjnë në Kosovë ky grup nga Universiteti i Berlinit.

Kosova dhe Shqipëria, ofertë të përbashkët turistike

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, dhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë, Blendi Klosi, gjatë një takimi në Prishtinë janë marrë vesh që Kosova dhe Shqipëria ta kenë një ofertë të përbashkët turistike. Sipas tyre, turizmi malor i Kosovës dhe turizmi veror i Shqipërisë do të vijë në një ofertë që vizitorët e huaj ta kenë destinacion Kosovën dhe Shqipërinë

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 MAJ - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të mërkurën në takim ministrin e Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë, Blendi Klosi, bashkë me kryetarët e Bashkive të Vlorës dhe Himarës, Dritan Leli dhe Jorgo Goro. Ministri Shala ka theksuar se me ministrin Klosi biseduan për thellimin e bashkëpunimit dhe për daljen e një oferte të përbashkët turistike. "Diskutuam me ministrin Klosi për thellimin e bashkëpunimit në fushën e turizmit, kompetencë kjo që është në domenin

e ministrisë që e drejtoj unë. Diskutuam edhe për mundësinë e krijimit të ofertave të përbashkëta, që turistët e huaj t'i kenë ofertat e përbashkëta për ata që vizitojnë Shqipërinë, ta vizitojnë edhe Kosovën dhe anasjelltas. U pajtuam bashkë me Klosin që tur-operatorët nga Kosova dhe Shqipëria të ofrojnë stande të përbashkëta për promovim të turizmit dhe të ofertave që i kemi si dy shtete", ka thënë ministri Shala. Ai ka bërë me dije se gjatë vitit Kosovën e vizitojnë afër pesë milionë vizitorë dhe afër 26 për qind janë nga Republika e Shqipërisë ose mbi 800 mijë.

Ndërsa ministri Klosi ka thënë

se shumë qytetarë nga Kosova e kanë destinacion Shqipërinë gjatë sezonit të verës, duke theksuar se barrierat administrative nuk mund ta pengojnë

turizmin. "Ne nuk do të duhet të mendojmë që deti është i shtetit shqiptar, ai është pasuri e gjithë kombit shqiptar. Ne duam ta ofrojmë turizmin më

të bukur të Shqipërisë dhe të Kosovës. Oferta e Shqipërisë dhe Kosovës nuk mund të pengohet nga barrierat administrative", ka thënë Klosi.

Autostrada 'Arbën Xhaferi' në fazën finale, përrurimi më 29 maj



PRISHTINË, 22 MAJ - Autostrada Prishtinë - Hani i Elezit, që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut, pritet të inaugurohet më 29 maj të këtij viti. Realizimi i këtij projekti ka filluar në vitin 2014, kurse punët sipas planit është dashur të

përfundojnë në fund të vitit të kaluar por, siç është thënë, kushtet e pafavorshme atmosferike kanë ndikuar në shtyrjen e përfundimit të këtij projekti. Kjo autostrada, e quajtur "Arbën Xhaferi", tash për tash shtrihet

nga Prishtina deri në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut, kurse në të ardhmen e afërt do ta lidhë Prishtinën dhe Shkupin. Ajo ka një gjatësi prej 60 kilometrash. Në të përfshihet edhe ura më e gjatë në rajon, ura e

Kaçanikut, me gjatësi prej gjashtë kilometrash.

Zëvendësministri i Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se tashmë gjithçka është në fazën finale dhe në fund

të muajit pritet inaugurimi zyrtar. "Sa iu përket punimeve janë në fazën e fundit, është pastrimi i trasesë, vendosja e shenjave të komunikacionit, kështu që shpresojmë se gjithçka do të jetë gati më 29 maj", ka thënë Kadriu.

Petrova së shpejti bëhet me park të ri

SHTIME, 22 MAJ (ER) - Në kuadër të projektit dyvjeçar për rregullimin e parqeve në hapësirat publike, këto ditë në fshatin

Petrovë të Shtimes ka filluar rregullimi i një parku të ri në qendër të fshatit. Përgjegjësi për ndërtim, Fatmir Rexhepi,

ka bërë me dije se ky projekt është duke u realizuar me financim të Komunës së Shtimes. Ai ka thënë se vlera e

projektit është mbi 4 000 euro, ndërsa punimet është duke i kryer "Ledi ING" nga Carraleva.



Fillojnë aplikimet për pjesëmarrje në Festivalin 'Bunarfest'

PRIZREN, 22 MAJ (ER) - Një prej festivaleve më unik në Kosovë, "Bunarfest", ka shpallur të hapur thirrjen për aplikim për të interesuarit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e garës së lëshimit me goma në lumin Lumëbardhi të Prizrenit, në kuadër të edicionit të 15-të të festivalit "Bunarfest". Organizatorët kanë bërë me dije

tashmë se ky edicion do të mbahet nga 8-9 qershor, ku së pari më 8 qershor (e shtunë) do të organizohet aktiviteti i pastrimit të lumit me vullnetarë dhe në mbrëmje do të organizohet koncerti muzikor me artistë të njohur nga vendi, derisa më 9 qershor (e diel) do të organizohet gara e lëshimit me goma, shtegu i së cilës fillon nga loka-

cioni i njohur si "Centralla" dhe përfundon në qendër të qytetit tek "Ura e Gurit", ku është edhe finishi i garës. Sikurse edhe në vitet e mëparshme, festivali nuk do të ketë karakter garues dhe qëllimi mbetet që në formë atraktive dhe argëtuese t'u jepet mesazhi qytetarëve për ta mbrojtur dhe mos e ndotur lumin.

PDK-së i largohen dy asamblastë në Malishevë

MALISHEVË, 22 MAJ (ER) - Në mbledhjen e pestë të rregullt të Kuvendit të Komunal të Komunës së Malishevës, dy anëtarë të këtij institucioni nga radhët e PDK-së, Kastriot Berisha dhe Florentina Zulfaj, kanë bërë me dije se janë tërhequr nga grupi i asamblastëve i PDK-së në Kuvendin e Komunës së Malishevës dhe do të veprojnë të pavarur brenda Kuvendit të Komunës së Malishevës. "Unë Kastriot Berisha, më i votuari në zgjedhjet e fundit nga radhët e PDK-së dhe Florentina Zulfaj, femra më e votuar në grupin e anëtarëve të PDK-së në Kuvendin e Komunës së Malishevës, deklarojmë se tërhiqemi nga të

qenit pjesë e grupit të PDK-së dhe do të vazhdojmë të veprojmë të pavarur brenda Kuvendit të Komunës së Malishevës. Për arsyet e këtij veprimi opinioni do të njoftohet me kohë përmes rrjeteve sociale", ka deklaruar Kastriot Berisha, anëtar i Kuvendit Komunal të Malishevës. Pas këtij deklarimi, Zulfaj e Berisha i kanë ndërruar edhe ulëset në Kuvend, duke u ulur prapa ulëseve të pjesës tjetër të anëtarëve të PDK-së.

PDK-ja në Malishevë në zgjedhjet e fundit lokale ka fituar nëntë ulëse në Kuvendin e Komunës, duke dalë partia e dytë me numrin më të madh të ulëseve në Kuvend.



Këtë vit do të fillojë ndërtimi i sallës së sportive në shkollën 'Shaban Jashari'



SKENDERAJ, 22 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se shënimi i ditës së shkollës "Shaban Jashari", që mbushi 93 vjet të themelimit të punës si institucion edukativo-arsimor, si dhe 95-vjetori i lindjes së heroit tonë kombëtar Shaban Jashari, i gjen në nivelin më të lartë të përkushtimit si qeveri komunale, për ngritje të cilësisë në arsim, në të gjitha shkollat e komunës dhe në të gjitha ciklet e arsimit.

Jashari ka thënë se Shkolla Fillore "Shaban Jashari" sot e kësaj dite, që prej vitit 2013, kohën kur është ndërtuar, vuan mungesën e një sale të sportit, me çka iu është mohuar padrejtësisht nxënësve mundësia ta zhvillojnë lëndën e edukatës fizike në kushte të përshtatshme, por edhe aktivitete të tjera sportive. "Por kjo gjendje tashmë ka marrë fund, pasi sivjet do ta fillojmë

ndërtimin e sallës së sportive për shkollën 'Shaban Jashari', do të vijojmë me ndërtime të sallave edhe në fshatrat Polac, Likoc dhe Rezallë, si dhe për shkollën 'Anton Çetta'. Kemi ndërmarrë dhe po ndërmarrim çdo ditë veprime konkrete, për të investuar në sferën e arsimit, siç janë: finalizimi i projektit për fuqizim të kabineteve të informatikës në shkollat e qytetit; dyfishimi i mjeteve financiare për transportin e nxënësve; rritja e buxhetit për ndarje të bursave për nxënës të shkollave të mesme; ndarja e 164 bursave për studentë të dalluar të Skenderajt", ka thënë kryetari Jashari.

Ai ka shtuar se vetëm me angazhim të shtuar nga ana e mësimit në mesuesi profesionin e tyre fisnik meqë mësuesi llogaritet si prind i dytë dhe me mësim nga ana e nxënësve do të krijohet baza për një shoqëri të emancipuar dhe të edukuar.

Nënshkruhet marrëveshje për përkrahjen e fermerëve të Kamenicës

KAMENICË, 22 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, bashkë me kompaninë "Shell Kosova" kanë nënshkruar një marrëveshje për përkrahjen e

fermerëve. Qëllimi i kësaj marrëveshje është motivimi i fermerëve nëpërmjet ndihmave dhe subvencioneve të shumta që të punohet toka dhe të zbutet papunësia.

Kryetari Kastrati ka thënë se po shfrytëzon çdo mundësi që t'u dalë në ndihmë fermerëve. "Të gjithë fermerët e Kamenicës që janë të regjistruar në Drejtorinë

për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me këtë marrëveshje do të përfitojnë zbritje të çmimit për derivate, nga 05 cent për çdo litër", ka thënë Kastrati.



Vështrim mbi sigurinë në komunikacion



Shkrim autorial nga Ferat SHALA & Liridon SEJDIU

Republika e Kosovës, si shtet i ri, në rrugëtimin e saj të tranzicionit po bart me vete specifika shumë të veçanta politike, ekonomike dhe sociale. Në esencë, ky rrugëtim i Kosovës me vete po bart edhe plagë të së kaluarës dhe të tashmes, plagë të cilat do të duhej të shëroheshin dhe të mbylleshin me një afat sa më të shkurtër, që rrugëtimi i shtetndërtimit dhe i zhvillimit të jetë më i shpejtë, më dinamik, më i shëndetshëm dhe më reprezentues brenda dhe jashtë vendit.

Në kuadër të këtij procesi, plagë dhe dhimbje aktive për Republikën e Kosovës po vazhdon të jenë edhe çështja e sigurisë në komunikacion.

Gjendja në komunikacion jo vetëm që nuk po përmirësohet, por po përkeqësohet në shumë dimensione. Ky problem po përcillet me një shkallë të lartë fataliteti, ku numri i aksidenteve me fatalitet, i atyre me lëndime të rënda e të lehta, si dhe i atyre me dëme materiale, është vërtet shqetësues dhe, si i tillë, paraqet problem të madh social dhe ekonomik për vendin tonë.

Humbja e jetës së njerëzve, nga të gjitha grupmoshat, duhet të na sensibilizojë të gjithëve për të gjetur mënyra praktike për hartimin e politikave dhe strategjive të reja, që ky problem të fillojë të zgjidhet dhe që shkalla e aksidenteve të zvogëlohet deri në minimum. Problemi i aksidenteve në komunikacion është dukuri globale, prandaj ne duhet të shohim se ku jemi në relacion me shtetet dhe popujt që kanë specifika zhvillimore të njëjta, apo të përafërta me vendin tonë.

Ne duhet të shohim se ku jemi në raport me këtë problematikë, në relacion me vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe me shtetet e zhvilluara në përgjithësi. Por, për të parë më konkretisht se si qëndron puna në nivel global, në lidhje me të dhënat statistikore të aksidenteve, më poshtë po i citojmë shkurtimisht disa të dhëna (burime) të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH): Përafërsisht 1.35 milionë njerëz humbin jetën si rezultat i aksidenteve në trafik; Aksidentet në trafik i kushtojnë shteteve afër 3 për qind të GDP-

së (Bruto Produkti Vendor) së tyre; Afër 93 për qind e aksidenteve me fatalitet ndodhin në vendet në zhvillim, ndërsa këto vende kanë 60 për qind të automjeteve në pjesëmarrjen e përgjithshme në botë; Mesatarisht rreth 30 milionë lëndimet nga aksidentet e trafikut ndodhin brenda një viti. Ndërsa në Kosovë, në bazë të të dhënave nga Policia e Kosovës, nga viti 2014 deri në vitin 2018 janë regjistruar 6 217 aksidente me lëndime, 549 aksidente me fatalitet dhe 631 persona kanë humbur jetën nga aksidentet në komunikacion.

Në këtë periudhë kohore (2014-2018) viti 2016 ka qenë viti me më së paku persona të vdekur në aksidente, me 110 raste, ndërsa viti 2017 ka qenë viti me më së shumti, 137 raste të vdekjeve nga aksidentet në komunikacion.

Nëse bëhet një krahasim ndërmjet vitit 2014 dhe 2018, kemi rritje të aksidenteve me lëndime për +27.50 për qind, ulje të aksidenteve me fatalitet për 9.90 për qind dhe rritje të rasteve të vdekjeve për +0.7 për qind.

Ky fenomen shqetësues është i pranishëm edhe në vendet e BE-së. Për ta zvogëluar numrin e aksidenteve, BE-ja ka caktuar objektiva strategjike, duke përdorur të gjithë mekanizmat institucionalë e shkencorë dhe duke përdorur të gjithë faktorët ndikues për t'i arritur synimet për zvogëlimin e aksidenteve. Po e ilustruam këtë sukses të BE-së duke pasqyruar statistikën dhe analizën e 32 shteteve të BE-së për periudhën 2010-2014, ku numri i aksidenteve me fatalitet është zvogëluar në mesataren 18 për qind, edhe

pse synimet e BE-së janë që në vitin 2020 ta arrijnë mesataren e zvogëlimin të aksidenteve me fatalitet në 24 për qind (Burimi: Këshilli Evropian për Sigurinë e Transportit).

Të dhënat e OBSH-së dhe të institucioneve të tjera ndërkombëtare alarmojnë për një situatë të rëndë dhe me tendencë përkeqësimi. Secili shtet, qoftë rajonal, qoftë botëror, ka të veçantat e veta edhe në planin zhvillimor, social, të sigurisë së përgjithshme, por i ka edhe planet dhe strategjitë e veta drejt synimeve integruese. Kosova domosdo është e orientuar në fushën e politikave integruese drejt Bashkimit Evropian. Për t'i arritur këto synime integruese nevojitet që të kemi qarësi dhe dinamikë për plotësimin e shumë kritereve dhe standardeve edhe në fushën e komunikacionit, të transportit të brendshëm dhe relacionit ndërkombëtar.

Për shkak të specifikave dhe rrethanave historike Kosova është trajtuar (dhe ende trajtohet) si vend i izoluar në fushën e komunikacionit rajonal dhe ndërkombëtar. Ende nuk kemi lidhje me korridoret rrugore evropiane.

Por, t'i kthehemi konkretisht temës bosht që sot është kthyer në shqetësim kolektiv në Republikën e Kosovës: siguria në komunikacion dhe numri i aksidenteve.

Për ta trajtuar këtë temë duhet analizuar një numër të caktuar të faktorëve bazikë shkencorë. Pra, nuk ka shërim të kësaj plaje pa njohur dhe diagnostikuar qartë shkaktarët. Vetëm pasi t'i kemi identifikuar qartë faktorët ndikues ne mund të marrim hapa dhe veprime për ta sanuar apo zvogëluar këtë

dukuri.

Hulumtimet e shumta shkencore determinojnë qartë se janë katër faktorë kryesorë që ndikojnë në shkallën e aksidenteve në përgjithësi, e këta janë: Faktori njeri; Faktori rrugë; Faktori automjet dhe Mjedisi.

Secili nga këta faktorë është ndikues veç e veç. Ndikimi i tyre pastaj gërshetohet edhe me mjedisin dhe me faktorë të tjerë dytësorë. Gërshetimi dhe kombinimi i këtyre faktorëve kërkon analizë dhe studim në nivel vendi, me pjesëmarrje të institucioneve politikëbërës në fushën e sigurisë së komunikacionit, të institucioneve ligjvënëse, institucioneve edukative-arsimore dhe shkencore, institucioneve të sigurisë, gjyqësorit, si dhe të institucioneve të tjera sociale dhe të planifikimit hapësinor, që deri më tani këto institucione, diku më shumë e diku më pak, praktikisht janë të dështuara. Të gjitha politikat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë, janë hartuar pa një analizë paraprake të mirëfilltë për fushën e sigurisë së komunikacionit. Secili nga këto institucione është temë e veçantë e trajtimit në fushën e komunikacionit. Shpresoj dhe besoj se hap pas hapi do t'i trajtojmë në punimet dhe shkrimet tona në vazhdim.

Faktori njeri

Tashmë është fakt i njohur se përgjegjës dhe faktor kryesor për shkallën kaq të lartë të aksidenteve është vetë faktori njeri. Studimet e ndryshme tregojnë se pjesëmarrja e faktorit njeri në aksidente është 80-85 për

qind, ndërsa pjesa tjetër 15-20 për qind janë faktorët e tjerë, si: rruga, automjeti dhe mjedisi.

Këto statistika na tregojnë qartë se nëse dëshirojmë ta zvogëlojmë numrin e aksidenteve në nivel vendi, institucionet përgjegjëse shtetërore duhet të kenë parasysh se të gjitha politikat, strategjitë dhe investimet duhet orientuar në faktorin njeri, gjë që deri më tani nuk ka ndodhur dhe nuk po ndodh. Fatkeqësisht, ky është problem parësor dhe shqetësues.

Nuk mund të zgjidhen problemet e sigurisë rrugore pa e trajtuar me top-prioritet faktorin kryesor: njeriun. Nëse institucionet tona shtetërore vetëm në dekadën e fundit kanë investuar dhjetëra miliardë euro në faktorin rrugë, bëjmë pyetje: sa investuam në faktorin njeri? Pak, fare pak!

Si të investohet në faktorin njeri?

Fushat dhe sektorët institucionalë shtetërorë duhet ta rrisin shkallën e përgjegjësisë dhe të vetëdijesimit me prioritet të lartë, në mënyrë që të hartohet apo qartësohet rruga e investimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë në faktorin njeri, si faktor kryesor i sigurisë së komunikacionit dhe sigurisë së përgjithshme. Faktori njeri sa është i rëndësishëm po aq është edhe kompleks e specifik me karakteristikë të tij personale, me vetitë psiko-fizike, me edukimin dhe kulturën e tij, me personalitetin etj. Andaj, në këtë specifikë sociale, psikologjike, ekonomike, edukative, por edhe teknike e shkencore, duhet një trajtim multi-institucional. Bashkërisht duhet të trajtohet procesi i edukimit dhe i formësimit të faktorit njeri, qoftë si ngasës apo si këmbësor i përgatitur, i edukuar dhe i kulturuar njëherësh.

Për ta përgatitur faktorin njeri për komunikacion, pjesëmarrës duhet të jenë këto institucione: Ministria e Arsimit dhe institucionet e tjera arsimore dhe shkencore (shkollat e të gjitha niveleve, universitetet, institutet, shoqëria civile); Ministria e Infrastrukturës; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Këto ministri do të duheshin t'i bashkërendojnë hapat institucionalë në identifikimin e problematikave bazike në rastin konkret të faktorit njeri. Këto institucione duhet të veprojnë me urgjencë për një epokë të re për faktorin njeri në komunikacion.



E jashtëzakonshme

Prindërit harrojnë foshnjën e porsalindur në taksi

Dy prindër në Hamburg të Gjermanisë përjetuan dhimbjen më të tmerrshme vetëm pak orë pasi mirëpritën fëmijën e dytë në familje. Kur po ktheheshin nga spitali, ata harruan foshnjën e porsalindur në taksi. Babai u përpoq ta ndalonte taksistin, por nuk ia doli. Taksisti nuk e kuptoi se ka një foshnje në veturë dhe doli për të ngrënë



drekë. Prania e fëmijës u vu re nga një pasagjer që hipi më vonë në taksi. Shoferi telefonoi policinë dhe, pas një kërkimi të vogël, i porsalinduri u bashkua me familjen.

BARSOLETA E DITËS



Tre shokët dhe fëmijët e tyre:
 - Djali im me gjasë do të bëhet avokat. Që tani përdor argumente.
 - Djali im do të bëhet veterinar, thotë i dyti, sepse ka filluar t'i vizitojë kafshët.
 - Im bir me siguri do të bëhet kamerier kur të rritet. Sa herë e thërras, asnjëherë nuk vjen.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit ne ora 14:00

“DUMBO” 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
 Regjia: Tim Burton




FOTO E DITES



Një person i skuadrës së zjarrfikësve shihet duke tentuar ta shpëtojë një vizitor i cili kishte mbetur në strukturën e kështjellës së Eiffelit në Paris, i cili kishte thyer rregullat e një vizitori. /AP/

Ne ora 16:00 dhe 19:00

“AVENGERS; Endgame”

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
 Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

“EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE”

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
 Regjia: Joe Berlinger



E rrallë

Ngjitet në Everest dy herë brenda javës, vendos rekordin e ri

Sherpa nga Nepali ka vendosur një rekord të ri të malit Everest. Ai ka arritur majën Everest për herë të 24-t, duke u ngjitur më 15 maj dy herë brenda shtatë ditësh. 49-vjeçari Kami Rita Sherpa ka pohuar se nuk planifikon të tërhiqet dhe shpreson të arrijë më shumë suksese në vitet e ardhshme.



16.05.2019

“THE HUSTLE”

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Konfuzion i brendshëm midis ndjenjës dhe arsyes sot nuk do t'ju lë të qetë. Nuk dini se kush do të jetë udhëheqësi juaj për ditën e sotme.</p>	 <p>DEMI Dite e ngjeshur sa i përket anës profesionale. Familja dhe miqtë do t'ju mirëkuptojnë sot dhe do t'ju lënë të qetë të përqendrohni në punë.</p>	 <p>BINJAKËT Sot ndjenjat tuaja do të jenë të kundërta nga ato të partnerit. Gjithsesi do të dini të kompensoni njëri-tjetrin në sintoni të plotë.</p>	 <p>GAFORRJA Disa situata të komplikuar nuk do ta prishin rrjedhën e ditës që do të vazhdojë të jetë e qetë dhe pa ndonjë zhvillim të rëndësishëm.</p>	 <p>LUANI Njerëz që kanë ikur larg jush dhe mendimeve tuaja befasi do të bëhen të gjallë. Kjo do të prishë gjithë ekuilibrat që kishit vendosur më parë.</p>	 <p>VIRGJERESHA Kjo nuk është një nga ato ditët me të mira për t'u shënuar në kalendar. Gjërat nuk shkojnë dhe aq mirë, por ju jeni mësuar me këtë fakt.</p>
 <p>PESHORJA Edhe pse sot nuk do të shkëlqeni në komunikim do të dini të vini pikat mbi "i" tek ato çështje që ju shqetësojnë ju personalisht dhe të afërmit tuaj.</p>	 <p>AKREPI Një ditë domethënëse në planin financiar. Fitime dhe blerje që ju bëjnë më të lumtur, por që nuk do të ndryshojnë jetën tuaj.</p>	 <p>SHIGJETARI Dyluftimi i planetëve në shenjen tuaj do t'ju bëjë që të jeni disi të turbullt në marrjen e vendimeve. Luhatjet e humorit do të kenë pasoja tek të tjerët.</p>	 <p>BRICJAPI Sot puna do t'ju duket mjaft e mërzitshme. Mundohuni që këto që mendoni të mos i shprehni me zë të lartë. Mund të keni probleme.</p>	 <p>UJORI Në çdo situatë ju do të ndiheni të rëndësishëm sot. Kjo falë aftësive tuaja profesionale, por sidomos falë komunikimit të shkëlqyer që keni.</p>	 <p>PESHQIT Raportet miqësore sot nuk do të jenë në kulmin e tyre. Disa hatërmbetje të shkuara do të dalin në sipërfaqe duke ndezur debat me miqtë.</p>

Gjykata liron Shakirën nga akuzat për plagjiaturë



Një gjykatë spanjolle i ka liruar nga akuzat për plagjiaturë Shakirën dhe Carlos Vives për këngën "La Bicicleta", që është edhe fituese e Garmmyt. Livan Rafael Castellanos, një këngëtar nga Kuba i

njohur si Livam, ka thënë se Shakira ka kopjuar pjesë të tekstit nga kënga e tij e quajtur "Yo te quiero tanto". "Nuk ka asnjë plagjiaturë siç pretendon paditësi në këtë rast", është thënë në vendimin e gjykatës.

Rihanna jep detaje rreth albumit të ri



Rihanna ka folur për muzikën e re. Fansat e këngëtares 31-vjeçare kanë pritur disa vite për muzikë të re nga ajo dhe tani Rihanna dha disa detaje rreth albumit të saj të ardhshëm. Rihanna ka thënë për "T

Magazine" se ajo është duke bërë një album 'Reggae' edhe pse nuk e di kur do të lëshohet dhe ende nuk ka një titull. Këngëtarja, po ashtu, konfirmoi se në album ka bashkëpunime me Lady Gaga dhe Drake.



I pensionuar, legjenda Ronaldo ka më shumë kohë për qejf

Ai është një nga futbollistët me të mëdhenj në botë. Ronaldo Luis Nazario de Lima, i njohur si Ronaldo, ndonëse i pensionuar, vazhdon të mbetet idhulli i shumë futbolldashësve. Ai është duke kaluar pushimet me të dashurën e tij, modeluesen Celina Locks. Të dy

janë parë në një ishull spanjoll teksa Ronaldo kishte të veshur një këmishë të bardhë dhe një palë pantallona të shkurtër ngjyrë të gjelbër. Ndryshe legjenda e futbollit është tërhequr zyrtarisht nga futbollit profesional më 2011 pas një karriere të gjatë dhe të shkëlqyer.

Justin Bieber bëhet shkak i mbylljes së një kanioni në Islandë

Justin Bieber u bë shkak pa dashje që një nga kanionët në Islandë të mbyllet. Këngëtarja 25-vjeçare xhirori klipin e këngës "I'll Show You" në vitin 2015 dhe fansat janë grumbulluar më pas për të bërë fotografi atje. Zyrtarët në Islandë vendosën të mbyllin kanionin për shkak të sigurisë. Edhe pse litarët dhe shenjat u vendosën për t'i mbrojtur vizitorët nga shkëmbinjtë, disa kanë injoruar të gjitha masat e sigurisë për të bërë fotografi.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82



UEFA mbështet FFK-në

UEFA do të vazhdon mbështetjen për Federatën e Futbollit të Kosovës edhe në të ardhmen. Ketë lajm e ka konfirmuar të mërkurën në Prishtinë, shefi i Divizionit të Federatave Kombëtare të UEFA-s, Thierry Favre. Ndërsa kryetari i FFK-së, Agim Ademi bëri me dije se futbollit i Kosovës do të vazhdon me reforma dhe se nga viti 2020/2021 në Superligë do të jenë vetëm 10 ekipe



ndryshime në futbollin e Kosovës. "Viti 2020/2021 do të na gjejë me sistem të ri të garave. Superliga do të jetë me 10 ekipe, dhe zinxhir edhe ligat tjera do të pësojnë ndryshime eventuale", ka thënë Ademi.

Morina-Bunjaku, Favres: Do të investojmë në infrastrukturë

Shef i Divizionit të Federatave Kombëtare të UEFA-së, Thierry Favre të mërkurën është pritur edhe nga zëvendësimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe

Sportit, Leonora Morina-Bunjaku. Temë e takimit ishte diskutimi për projektet e realizuara deri më tani si dhe për projektet që e presin në të ardhmen FFK-në. Zëvendësimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Morina-Bunjaku konfirmoi se Qeveria e Republikës së Kosovës, MKRS-ja, do të jenë të gatshme për të bashkëpunuar me UEFA-në për ndërtimin e Stadiumit Nacional si dhe 6 fushave ndihmëse të futbollit. Zëvendësimin e informoi përfaqësuesin e UEFA-së që në koordinim me FFK-në investon në projekte kapitale dhe e përkrah drejt-

përdrejtë futbollin në baza të rregullta vjetore. "Në emër të MKRS-së premtova bashkëpunim dhe krijim të infrastrukturës me standarde evropiane, përderisa talenti dhe të ariturat në futbollin e Republikës së Kosovës nuk mungojnë", ka thënë Morina-Bunjaku. Ndërsa, Thierry Favre, ka thënë se tashmë pasi Kosova është pranuar në UEFA dhe FFK-ja po angazhohet në avancimin e sportit të futbollit, mbetet që Ministria e Sportit dhe Qeveria të fokusohen në investimin në infrastrukturë dhe në nxjerrjen e talenteve të rinj.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 MAJ - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) dhe futbollit në përgjithësi e ka përkrahjen e UEFA-s. Ketë e ka bërë të ditur të mërkurën në konferencë për medie, shefi i Divizionit të Federatave Kombëtare të UEFA-s, Thierry Favre, i cili është duke qëndruar për një vizitë në Kosovë. "Jam i lumtur që jam sërish këtu. Ka kaluar kohë e gjatë që nga vizita ime e fundit në shtator e cila ishte e mrekullueshme, gjatë inaugurimit të stadiumit 'Fadil Vokrri'. Në mëngjes më është prezantuar versioni i përmirësuar i qendrës së stërvitore në Obiliq, i cili është i mirë dhe besoj të fillojë këtë verë. Tash keni kushte më të mira se më parë, krahasuar me objektin tjetër, por besoj që do të keni vizion për të pasur një zyrë edhe më moderne dhe me gjasë do të përfitoni nga mbështetja financiare dhe teknike e UEFA-s", ka thënë Favre, i cili ka konfirmuar se në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s do të miratohet vendimi që nga viti i ardhshëm Kosova të përfaqësohet

me tri klube në garat evropiane. Ndërsa edhe një befasi tjetër do të jetë nga takimi i KE të UEFA-s në Baku, të cilën Favre nuk e bëri publik. Ndërsa pjesëmarrjen e tri skuadrave të Kosovës në arenën ndërkombëtare e konfirmoi edhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. "Në Budapest gjithmonë kemi marrë lajme të mira, dhe disi aty jemi pranuar dhe tash është bërë një lajm i mirë për ekipet, pasi që është shtuar një ekip. Në fakt kjo është shtuar nga Giorgio Marchetti i cili është përgjegjës për këtë punë, edhe pse nuk e kemi arritur koeficientin, por kemi bërë kërkesa të llojllojshme dhe sikur është shpërblyer puna jonë dhe klubet tona të cilat kanë qenë në gara evropiane vitin e kaluar kanë kaluar një fazë më lartë, Drita dhe Prishtina dhe aty është një poentë. Gjithsesi këtu impaktin e ka edhe kombëtarja jonë e cila është me një sukses të madh. Ajo është vendosur por miratimi në njëfarë mënyrë siç thuhet bëhet në Baku për faktin se aty mbledhet komplet komiteti ekzekutiv", ka thënë Ademi, i cili konfirmoi me këtë rast se nga viti 2020/2021 do të ketë

Shtatë shtete nderojnë turneun 'Lah Nimani'



PRISHTINË, 22 MAJ - Federata e Boksit e Kosovës ka bërë me dije se shtatë shtete do ta nderojnë me pjesëmarrje turneun ndërkombëtar "Lah Nimani". Sipas drejtuesve të Federatës së Boksit, për shkak të mjeteve financiare në këtë turne janë ftuar vetëm gjashtë shtete. Në turneun për legjendën e boksit shtetet pjesëmarrëse do të prezantohen me

boksierë 17 dhe 18-vjeçar. Turneu do të jetë dyditor dhe zhvillohet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Gjysmëfinalet zhvillohen më 25 maj nga ora 16:00, kurse finalet zhvillohen më 26 maj. Pjesëmarrës në këtë turne do të jenë boksierët nga Belgjika, Bullgaria, Maqedonia, Mali i Zi, Gjermania, Shqipëria dhe Kosova. Drejtësinë në këtë

turne do ta ndajnë dy gjyqtarët nga Kosova, Latif Demolli, Rustem Konjuhi, Agim Shala, Agim Tahiraj, Rasim Rustemi, Safet Sylja, Fadil Bekteshi, Visar Ibrahim i e Granit Qorri si dhe ai nga Bullgaria, Georgi Georgiev. Matës kohe do të jenë Fisnik Latifi, Marigona Beadini e Fatlum Agushi, delegat Sylejman Voca dhe mjek kujdestar Agron Kamberi.

Lista e Challandesit me risi

PRISHTINË, 22 MAJ - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, ka bërë publike listën e futbollistëve për dy ndeshjet e qershorit në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020". Kosova më 7 qershor do të luajë kundër Malit të

Zi në Podgoricë dhe më 10 qershor kundër Bullgarisë në Sofje. Stërvitja e parë e kompletuar do të mbahet më 2 qershor në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 18:00. Risi në listën e trajnerit zviceran, përveç Florent Hadergjonajt që grumbullohet

për herë të parë, janë edhe mbrojtësi i Heerenveenit, Ibrahim Dresheviqi dhe mesfushori i Vikingit, Ylldren Ibrahimaj. Stërvitja e parë e kompletuar do të mbahet më 2 qershor në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 18:00.

LISTA E LOJTARËVE

Ujkani, Muriqi, Bekaj, Rrahmani, Aliti, Vojvoda, Hadergjonaj, Kololli, Paqarada, Dresheviq, Kryeziu, Shala, Voca, Rashkaj, Halimi, Ibrahimaj, Celina, Hasani, Zhegrova, Rashani, Zeneli, Rashica, Muriqi, Nuhii, Demhasaj.



Kloppi në listën e dëshirave të Juventusit

TORINO, 22 MAJ - Juventusit është në kërkim të një trajneri që do ta zëvendësonte Massimiliano Allegrin. Në orët e fundit është shfaqur edhe emri i Jurgen

Kloppit, i cili aktualisht është trajner i Liverpoolit. Arritja e një marrëveshje me trajnerin gjerman duket shumë e vështirë për "Zonjën e Vjetër",

pasi vetë Kloppi disa herë radhazi ka konfirmuar se është i lumtur në "Anfield". Nëse arrihet kjo marrëveshje Juve duhet të sigurojë një pagë prej tetë

milionë eurosh në sezon dhe duhet ta paguajë klauzolën e kontratës së tij me klubin anglez prej 36 milionë eurosh.



Ramadani dhe Muhaxheri presin paraqitje dinjitoze në Botëror

PRISHTINË, 22 MAJ - Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Taip Ramadani, ka thënë se Përfaqësuesja U21 do të udhëtojë në Spanjë për të dëshmuar që e meriton të jetë pjesë e ngjarjes më të madhe, kampionatit botëror për juniorë. Kampionati botëror i juniorëve zhvillohet në muajin korrik, ndërsa shorti është hedhur të martën në Pontevedra, njërin prej dy qyteteve ku zhvillohet botërori i 22-të i juniorëve. Është hera e parë që një përfaqësuese e Kosovës merr pjesë në botëror, pra hendbolli po shkruan kapitull të ri të historisë së sportit kosovar. Kosova U21 do të luajë në Grupin C së bashku me Portugalinë, Kroacinë, Hungarinë, Brazilin dhe Bahrejin.

"E kemi pasur të qartë që në grup do t'i kemi tri ekipe të forta evropiane dhe dy ekipe të tjera sipas fatit. Portugalia në vitet e fundit ka ecur shumë para me gjenerata të reja dhe është favorite në grupin tonë. Por kuptohet që edhe Kroacia e Hungaria janë superfuqi në këtë nivel. Gjithashtu, Brazili e Bahrejni në 10 vjetët e fundit kanë prodhuar një sasi të madhe të talenteve vendorë dhe pres cilësi të lartë edhe nga këto dy ekipe kombëtare. Mirëpo duhet të kuptojmë se klasifikimet në kampionat botëror bëhen sipas cilësisë së dëshmuar



nga kampionati i fundit dhe kjo nuk do të thotë se këto grupmosha mund ta përsërisin suksesin e paraardhësve të tyre", ka thënë Ramadani, i cili ka shtuar se: "Ne ndihemi krenarë të jemi në mesin e ekipeve më të forta në botë dhe do të shkojmë me këtë mentalitet, që të dëshmojmë se e meritojmë të jemi në këtë ngjarje të madhe. Për sa kohë jemi në botëror, çdo gjë mund të ndodhë".

Për shortin foli edhe trajneri i Përfaqësues U21, Fatmir Muhaxheri. "Grupi është i fortë,

por në kampionate botërore nuk ka ekipe të lehta. Mendoj se do të përgatitemi mirë, ndërsa planin e përgatitjeve e kemi bërë tashmë. Përgatitjet fizike planifikojmë t'i fillojmë më 18 qershor dhe ato do të zgjasin deri më 26 qershor. Djemtë më pas do të kenë dy ditë pushim, para se të vazhdojmë me fazën e dytë. Faza e dytë përfundon më 3 korrik e më pas planifikojmë që fazën përfundimtare ta zhvillojmë jashtë vendit, ku do të kemi edhe ndeshje përgatitore", ka theksuar Muhaxheri.

Toronto barazon serinë e finaleve ndaj Milwaukee

MILWAUKEE, 22 MAJ - Ekuilibër në finalet "play-off"-it në Konferencën e Lindjes. Toronto fitoi sot 120-102 ndaj Milwaukee në takimin e katërt, duke barazuar 2-2 serinë e ndeshjeve. Ekipeve kanë fituar sfidat në fushën e tyre dhe tashmë seria spostohet në Milwaukee. Fitore e lehtë e skuadrës kanadeze, që vuajti vetëm në perioidën e parë. Më tej, ndeshja ishte një dominim total i skuadrës së Torontos, që u shkëput deri në 20 pikë në perioidën e katërt. Gjashtë lojtarë të ekipit kanadez realizuan mbi 10 pikë, me Lowry që ishte shënuesi më i mirë me 25 pikë. Madje 48 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit, që ishin çelësi i suksesit në këtë sfidë. Për Milwaukee u dalluan Middletoni me 30 pikë e Antetokounmpo me 25 pikë e 10 rebound, por të izoluar nga pjesa tjetër e skuadrës. Në Përfundim, skuadra e Golden State ka mbyllur serinë dhe është shpallur kampione (mposhti Portland), duke qenë në pritje ta mësojë emrin e rivalit në finalet e NBA-së.



SHKURT

'Spurs'-i e ka seriozisht transferimin e Hysajt

Emri i mbrojtësit të Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysajt, vazhdon të lakohet në Angli, aty ku tashmë e kërkon një tjetër skuadër londineze. Pas Chelseas dhe Arsenalit, është Tottenham Hotspuri që ka shfaqur interes për mbrojtësin kuqezi edhe pse, sipas "The Sun", ky i fundit mund të bëhet pjesë e shkëmbimit që do ta çojë mbrojtësin anglez Kieran Trippier te Napoli. Besohet se Hysaj është pro kalimit në Angli.

Dortmundi zyrtarizon Hazardin

Borussia Dortmund ka zyrtarizuar transferimin e Thorgan Hazardit nga Borussia Monchengladbach. Kjo është blerja e tretë në harkun e 24 orëve për nënkampionët e Gjermanisë, pasi konfirmuan afrimin e Nico Schulz për 25 milionë euro dhe atë të Julian Brandt, por për 25 milionë. Sulmuesi anësor i ka kushtuar 28 milionë euro Dortmundit dhe ka firmosur kontratë deri në vitin 2024 me verdhezinjtë, kurse në shpinë do ta mbajë numrin 8.

Varane nuk do ta braktisë Realin

Deri para disa muajsh largimi i tij nga Reali i Madridit dukej i sigurt në fund të këtij sezoni por, mesa duket, edhe Raphael Varane do ta ndjekë të njëjtin rrugë si Toni Kroos që vetëm dy ditë më parë rinovoi zyrtarisht kontratën me "Los Blancos". Në fakt, mbrojtësit francez nuk i është propozuar ende rinovimi i kontratës, por Varane ka vendosur të qëndrojë te Reali.

Rakitiqi: Nuk shkoj në Inter, jam i lumtur te Barça

Mesfushori i Barcelonës, Ivan Rakitiqi, ka konfirmuar se nuk do të transferohet tek Interi. Mesfushori kroat ka konfirmuar se është i lumtur në skuadrën e Barcelonës dhe se nuk e ka opsion largimin gjatë afatit kalimtar të verës. "Nuk e di pse më lidhin mua me Interin. Nuk mund ta sqaroj. I respektoj skuadrat e tjera shumë. Interi është një skuadër e mrekullueshme dhe ne kemi luajtur kundër saj këtë sezon. Kam bashkëlojtar atje dhe i respektoj ata, por është një gjë tjetër të shkosh atje. Jam aty ku dua të jem dhe nëse Interi po mendon për mua, atëherë kjo është sepse unë jam duke bërë punë të mirë, por jam i lumtur në Barcelonë", ka thënë Rakitiqi, i cili ka bërë me dije se edhe familja e tij është e lumtur në Barcelonë.

Fury, Wilderit: Ti dështak eja në 'Times Square'

Deontay Wilder e ka freskuar listën e fitoreve, duke i regjistruar në total 41 triumfe profesionale në fundjavën e kaluar. Ai e nokautoi brutalisht Dominic Breazeale qysh në raundin e parë për ta mbrojtur titullin e peshave të rënda WBC. Fatkeqësisht, amerikani i pamposhtur nuk do të përballlet me Tyson Fury. Ai pritet të përballlet me Luis Ortiz, por i vetëashtuqajtur 'Gypsy King' është i vendosur që të përballlet me Wilder, duke e sfiduar atë në Amerikë. "Wilderi është një hiq. Ai kishte fat në goditjen e tij të parë (ndaj Breazeales) - kjo është. Siç e thashë, Wilder është një dështak i madh, ai punon për mua", ka thënë Fury. "Kështu është Wilder, një dështak, një hiq, një llum - ku të dëshiron, në çdo vend, në çdo qytet. Kur do të përballlemi sërish, unë ju premtoj, ai do t'i shikojë vetë yjet mbi kokën e tij. Wilder, eja të përballlemi në 'Times Square' këtë mbrëmje, ti dështak", ka shtuar Fury.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosova



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE AND TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKE I TEHNOLOGJIJU

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA

STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
web: www.qendraestudenteve.com

Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, në bazë të Ligjit Nr. 03/L-212, neni 7 dhe 8 të Ligjit të Punës, të Republikës të Kosovës, publikon këtë:

KONKURS

Titulli i postit: 2. Dy: Punëtor/e në kuzhin-Enëlarës/e
Drejtor: Ushqimit
Vendimi: 1 (njëvjeçare)
Raporton te: Drejtori i t ushqimit
Koeficienti: 5.
Detvrat kryesore:

- Është përgjegjës për mënyrën e përdorimit të rregullt të makinës për larjen e enëve dhe për punën e saj normale
- Është i obliguar që ti ndihmoj banakierit gjatë pranimit të enëve
- Ndan inventarin sipas llojit dhe vendos në makinë për larje
- Kujdeset për mirëmbajtjen e rregullt të makinës dhe higjienës së saj
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të kryepunëtorit të ndërrimit dhe udhëheqësit të kuzhinës

Aftësitë:

- aftësitë e mira të komunikimit .
- gatishmëria për të vepruar me pak mbikëqyrje
- aftësi të mira ndër personale dhe mbajtja e kontakteve me personat vendimmarrës
- aftësi për përcaktimin e prioritetëve të punës dhe shkathhtësi për menaxhimin e kohës.
- njohja e obligueshme e gjuhëve zyrtare në përdorim.
- njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- mbikëqyr punët dhe aktivitetet në lëmin e teknologjisë së ushqimit

Kualifikimi dhe përvoja:

- shkolla e mesme
- së paku 1 (një) vjet përvojë pune

Titulli i postit: 1.Një: Punëtor/e në kuzhin-Mishpunues

Drejtor: Ushqimit
Vendimi: 1 (njëvjeçare)
Raporton te: Drejtori i t ushqimit
Koeficienti: 6.

Detvrat kryesore:

- Pranon nga depoja mishin dhe prodhimet e mishit të thatë,
- planifikon mishin për çdo ditë dhe mbanë evidencën mbi sasinë e shpenzuar.
- kujdeset mbi matjen e drejtë, vendosjen dhe ruajtjen e mishit të freskët dhe atij të përpunuar,
- kryen përpunimin e mishit dhe përgatit për racionet sipas listës së gjellërave,
- kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të Përgjegjësit të ndërrimit dhe Drejtorit të Drejtorisë të kuzhinës dhe restorantit.

Aftësitë:

- aftësitë e mira të komunikimit .
- gatishmëria për të vepruar me pak mbikëqyrje
- aftësi të mira ndër personale dhe mbajtja e kontakteve me personat vendimmarrës
- aftësi për përcaktimin e prioritetëve të punës dhe shkathhtësi për menaxhimin e kohës.
- njohja e obligueshme e gjuhëve zyrtare në përdorim.
- njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- mbikëqyr punët dhe aktivitetet në lëmin e teknologjisë së ushqimit

Kualifikimi dhe përvoja:

- përgatitja shkollore: Diplome e shkolles se mesme
- përvoja e punës: përvojë në punë dy vite (2)

Informacionet plotësuese:

- Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetat ditore.
 - aplikacionet merren /dorëzohen (bashkangjitur të gjitha dokumentet relevante në kopje) në Qendrën e studentëve të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, rruga Agim Ramadani, p.n. kati i dytë, nr. kontaktues i telefonit 038-223-951, prej orës 08.00 – 16.00,
 - aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohej aplikacionet e pakompletuara mund të refuzohen
 - kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen përmes telefonit.
- Qendra e studentëve është në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha komunitetet e Kosovës.

Naziv položaja: 2. Sudoper/ra-

Služba: Ishanc
Ugovor: 1 (jednogodišnji)
Izveštava kod: Rukovodioca Službe ishrane
Koeficijent: 5.
Glavni zadaci:

- Odgovoran je za način redovne upotrebe mašine za pranje sudova i za njen normalan rad
- Obavezan je da pomaže sankistu za vreme prijema sudova
- Deli inventar prema vrsti i postavlja u mašinu za pranje sudova
- Brine se za redovno održavanje mašine za pranje sudova i njenu higijenu
- Obavlja i druge poslove po naredbi glavnog šefa smene i rukovodioca kuhinje

Sposobnosti:

- Dobre sposobnosti komuniciranja
- Spremnost da deluje sa malim nadzorom
- Dobre međuljudske sposobnosti i održavanje kontakata sa osobama odlučivanja
- Sposobnosti za utvrđivanje prioriteta posla i snalažljivosti za menadžiranje vremena
- Obavezno poznavanje službenih jezika koji su u upotrebi
- Poznavanje engleskog jezika je prednost
- Nadzire rad i aktivnosti iz oblasti tehnologije ishrane

Kvalifikacija i iskustvo :

- Srednja škola ugostiteljstva ili neki drugi kmer
- Najmanje 1(jedan) godine radnog iskustva

Naziv položaja: 1. radno meso

Služba: Ishanc
Ugovor: 1 (jednogodišnji)
Izveštava kod: Rukovodioca Službe ishrane
Koeficijent: 6.
Glavni zadaci:

- prihvata meso i mesne proizvode iz skladišta,
- dnevno planira meso i prati utrošeni iznos,
- vodi računa o pravilnom mjerenju, postavljanju i očuvanju svežeg i preradenog mesa,
- obavljaju preradu mesa i pripremanje se za obroke prema listi posuda
- obavlja i druge poslove po nalogu zamjenskog službenika i direktora kulinarskog i restoranskog imenika.

Sposobnosti:

- Dobre sposobnosti komuniciranja
- Spremnost da deluje sa malim nadzorom
- Dobre međuljudske sposobnosti i održavanje kontakata sa osobama odlučivanja
- Sposobnosti za utvrđivanje prioriteta posla i snalažljivosti za menadžiranje vremena
- Obavezno poznavanje službenih jezika koji su u upotrebi
- Poznavanje engleskog jezika je prednost
- Nadzire rad i aktivnosti iz oblasti tehnologije ishrane

Kvalifikacija i iskustvo :

- Srednja škola
- Najmanje 2(jedan) godine radnog iskustva

Dopunske informacije:

- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.
- Aplikacije se uzimaju/predaju (uz priložene kopije svih potrebnih dokumenata) u Studentskom centru prištinskog univerziteta u Prishtini, ul. Agim Ramadani, bb. II sprat, broj kontakt telefona 038-223-951, od 08.00 – 16.00.časova
- Aplikacije koje su dostavljene nakon isteka roka neće biti primljene,
- Ne kompletirane aplikacije mogu biti vraćene.
- Kandidati koji budu selektirani u užu listu za intervjuisanje, biće naknadno informisani telefonom.
- Studentski centar je u službi svih građana i pruža jednake mogućnosti zapošljavanja pripadnicima svih zajednica na Kosovu.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister

ZYRA E KRYEMINISTRIT shpallë të lirë këtë vend të punës:

I. Një (1) Asistent Administrativ
Numri i referencës: ZKM-ZA-009
Koficijenti: 6

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Zyrës së Administratës Qendrore kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijojnë:

- Bashkërendon dhe është përgjegjës për punët administrative dhe operative të ZAQ-së;
- Siguron mbarëvajtje, organizim, administrim dhe menaxhim ditor të Zyrës.
- Ofron mbështetje në shërbimet sekretarie dhe administrative për Drejtorin e zyrës dhe Divizionet në kuadër të Zyrës së Administratës Qendrore .
- Aranzhon takime për mbikëqyrësin, pret palët, kryen dhe merr telefonata, u përgjigjet kërkesave rutinë për informata për ZAQ.
- Shkruan letër këmbim për çështje rutinë.
- Mbanë arkiv të zyrës , arkivimi I dokumenteve në formë elektronike (data bazë) për Zyrën e Administratës Qendrore dhe arkivimi në formë fizike.
- Përkujdeset për të gjithë dokumentacionin zyrtar dhe shkresat hyrëse/dalëse për Zyrën e Administratës Qendrore dhe Divizionet .
- Bënë fotokopjimin, sistemimin dhe shpërndarjen e dokumenteve të ZAQ
- Përgatit raportet përmbledhëse të ZAQ-së / Divizioneve (javore dhe mujore, vjetore);
- Kryen edhe punë tjera sipas nevojës me kërkesën e drejtorit të ZAQ-së.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diploma e shkollës së mesme.
- Tri(3) vite përvojë pune në administratë.
- Njohja e gjuhës shqipe dhe/ ose serbe. Njohja e gjuhës angleze etj është përparësi,
- Njohja e punës me kompjuter, programet Windows-it
- Aftësi në përpilimin e shkresave,
- Të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndërnjerëzore
- Të jetë i gatshëm të punoj me orar fleksibil dhe tryzni kohe.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Zyra e Kryeministrit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://www.kryeministri-ks.net/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i IV, zyra nr. 406.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrihen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese një (1) vjeçare.

Afati i konkurrimit është prej datës 23/05/2019 deri me datë 06/06/2019, deri në orën 16:00.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 14 818 dhe 038 200 14 817.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister

KANCELARIJA PREMIJERA objavljuje slobodnim sledeće radno mesto:

I. Jedan (1) Administrativni Asistent
Referentni broj: KP – CAK -009
Koficijent: 6

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom direktora Centralne administrativne kancelarije obavlja sledeće zadatke i odgovornosti:

- Koordiniše i odgovoran je za administrativne i operativne poslove CAK;
- Obezbeduje dobro dnevno odvijanje, organizaciju, administraciju i upravljanje kancelarijom.
- Pruža podršku sekretarskoj i administrativnoj službi za direktora Kancelarije i odeljenje u okviru Kancelarije centralne administracije.
- Aranzira sastanke za nadređenog, dočekuje stranke, obavlja i prima pozivce, odgovora na rutinske zahteve za dobijanje informacija o CAK
- Piše razmenu pisama o rutinskim pitanjima.
- Vodi arhivu kancelarije, vrši arhiviranje dokumenata u elektronskoj formi (baze podataka) za Kancelariju centralne administracije i arhiviranje u fizičkom obliku.
- Vodi brigu o celokupnoj zvaničnoj dokumentaciji i ulazne / izlazne dopise za kancelariju centralne administracije i odeljenja.
- Vršiti fotokopiranje, sistematizaciju i distribuciju dokumenata CAK
- Priprema sažete izvštaje CAK /odeljenja (nedeljne, mesečne i godišnje);
- Obavlja i druge poslove po potrebi, na zahtev direktora CAK.

Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:

- Diploma srednje škole.
- Tri (3) godine radnog iskustva u administraciju;
- Poznavanje albanskog i / ili srpskog jezika. Znanje engleskog jezika je prednost,
- Poznavanje rada na kompjuteru programi Windowsa
- Veštine u izradi dokumentacije,
- Biti energičan, imati sposobnost da gradi dobre međuljudske odnose
- Biti spreman da radi po fleksibilnom radnom vremenu i pod pritiskom.

OSNOVNI PODACI ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA KONKURISA

Kancelarija Premijera pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja aplikacije od strane svih zajednica na Kosovu.

Ne-većinske zajednice imaju pravo na fer i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe kao što je navedeno u članu 11. stav 3 Zakon br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo.

Uz aplikaciju se treba priložiti sledeća propratna dokumentacija: popunjeni obrazac za aplikaciju, dokaz o obrazovnim i stručnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu moraju biti verifikovane od strane MONI-a), dokaz radnog iskustva, dve reference .

Zahtev za zapošljavanje i opis radnog mesta se može dobiti na recepciji zgrade Vlade Republike Kosovo (ul. Majke Tereze bb). Zvanični obrazac za aplikaciju, možete naći i na web stranici: <http://www.rks-gov.net/pm/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacija mora biti dostavljena Kancelariji za ljudske resurse, zgrada Vlade, IV sprat, kancelarija br. 406.

Korišćenje pogrešnog obrazca i nepotpunog sa podacima koji su potrebni, će se smatrati nevažećim.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati koji su ušli u uži izbor će biti kontaktirani. Kandidati koji su izabrani u uži izbor će proći kroz pismeni ispit i intervju.

Trajanje imenovanja prema ZSL, uključujući i period probnog rada je godinu dana.

Rok za konkurisanje je od dana 23/05/2019 do dana 06/06/2019, do 16:00.

Prijave pristigle nakon poslednjeg roka konkursa neće biti prihvaćene.

Za dodatne informacije, pozovite brojevi: 038 200 14 818 i 038 200 14 817



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Departamenti i Tregtisë

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i lartë për mallra bujqësore dhe industriale
Koefficienti / 8
Nr. i Referencës: MTI/ 14
Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1
Vendi: Prishtinë

Data: 23/05/2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën e marrëveshjeve tregtare
- Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Bën hulumtime, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve në fushën e mallrave bujqësore dhe industriale;
- Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: Fakulteti Ekonomik, Bujqësi, Juridik, Shkenca Politike;
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën e tregtisë të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese. Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

06/06/2019

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën www.mti-ks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: 06/06/2019. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj službi Republike Kosovo, Zakon br. 03/L-149, Uredba Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo Trgovine i Industrije objavljuje:

REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije

Odeljenje za Trgovinu

Naziv radnog mesta: Viši službenik za poljoprivredne i industrijske proizvode
Koefficient / 8
Referentni Br: MTI/ 14
Broj zvaničnika koji će biti prihvaćeni: 1
Mesto: Priština

Datum: 23/05/2019

Dužnosti i odgovornosti:

- Razvija i postiže usvajanje za planove rada i rokova, u koordinaciji sa nadzornikom, za implementaciju relevantnih projekata, usluga i proizvoda u oblasti trgovinskih sporazuma;
- Obavlja predviđene zadatke u planovima rada usvojenim u skladu sa relevantnim zakonima, propisima, politikama i procedurama, u određenim rokovima;
- Izvršava istraživanje, analizu, procenu opcija i preporuka za pregled od visokih nivoa o zadacima ili projektima u oblasti poljoprivredne i industrijske robe;
- Pružava savete osoblju nižeg nivoa u okviru organizacione jedinice za izvršavanje njihovih dužnosti i odgovornosti;
- Pružava savete u oblasti stručnosti koja se zahteva unutar institucije;
- Koordinira rad sa drugim delovima institucije i komunicira, po potrebi, sa stranim vlastima;
- Obavlja bilo koji drugi zadatak u određenom profesionalnom polju u skladu sa važećim zakonima i propisima koji se mogu razumno zahtevati s vremena na vreme.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Univerzitetska Diploma: Ekonomski Fakultet, Poljoprivredni, Pravni, Politike Nauke;
- Minimum 3 godine stručnog iskustva;
- Duboko i specijalizovano znanje iz oblasti trgovine stečena kroz univerzitetsko obrazovanje i odgovarajuću obuku;
- Poznavanje važećih zakona i propisa;
- Veštine u komunikacije planiranju rada i vođstvu tima;
- Istraživačke, analitičke, procenjivačke veštine i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
- Kompjuterske veštine u programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);

Uslovi za učesće u regrutovanju:

Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova, koji su potpuno sposobni da deluju, imaju visoko obrazovanje i imaju profesionalnu sposobnost za obavljanje dužnosti.

Trajanje imenovanja:

Službenik karijere (trajni). Probni period: dvanaest (12) meseci.

Datum zatvaranja konkursa:

06/06/2019

Podnošenje zahteva

Obrasci za apliciranje preuzimaju se na recepciji MTI-a, ili se preuzimaju sa web stranice MTI-a, gde je objavljen konkurs, na adresi www.mti-ks.org i podnose se Diviziji za Ljudske Resurse, svakog radnog dana od 8:00 -16:00 časova do: 06/06/ 2019.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na tel. 038-200 36-578.

"Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu".

"Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno predstavljanje u organima civilne službe centralne i lokalne javne uprave kao što je definisano u Članu 11, stav 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo"

Nepotpune aplikacije i podnesene posle krajnjeg roka neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati izabrani na užem spisku će biti kontaktirani.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

